



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 752 prot.

Tiranë, më 5.4.2024

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të brendshëm (me procedurën e lëvizjes paralele brenda sistemit doganor)

Drejtuar: **DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE  
DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE  
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORISË SË KOORDINIMIT DHE MARRËDHËNIEVE ME  
JASHTË ✓**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të pikës 5, të nenit 15, të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuarm, të Kreut II dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921, datë 29.12.2014 "Për Personelin e Administratës Doganore", i ndryshuar, shpall konkurimin e brendshëm për pozicionet:

**Specialist, Sektori i Standardeve, Metodikave dhe Administrimit, Drejtoria e Labororit Doganor, Departamenti Teknik.**

Kategoria C1, Kategoria e pagës IV- 1, (1 pozicion pune)

**Përshkrim përgjithësues për pozicionin:**

- Specialisti i Sektorit përgjigjet tek tek Përgjegjësi i Sektorit S.M.A. në lidhje me, detyrat dhe udhëzimet e ngarkuara.
- Qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës si Specialist në Sektorin e Standardeve, Metodikave dhe Administrimit është të ndihmojë Drejtorinë e Labororit Doganor të përmbushë misionin e saj duke siguruar se e gjithë puna të kryhet në mënyrë ligjërishit korrekte, efikase.
- Të punojë në përputhje me S SH EN ISO/IEC 17025:2006 për një zbatim të drejtë të detyrave sipas këtij standardi për rritje dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë në laborator.

Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë këto kriteret:

**Kriteret minimale:**

- Të ketë një vlerësim pozitiv apo një certifikatë/vërtetim për një kualifikim të posaçëm profesional, që i përshtatet vendit të ri të punës
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- Të përmbushë kriteret e veçanta në shpalljen për konkurim

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar

#### **Kriteret e veçanta:**

- Arsimi i Larte Master Profesional në Shkencat e Inxhinierise Kimike dhe te ngjashme me to.
- Të ketë mbi 1 vitë eksperiencë punë në Administratën Doganore.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurrim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda datës 18.9.2024 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

1. Kërkesë për marrje pjesë në testim
2. Curriculum Vitae
3. Rekomandim nga eprori direkt.

#### **Fusha e Njohurive:**

1.Ligji nr102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

2. VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë.

3. Ligji nr. 61/2012 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:

4. Ligji nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar.

5. Urdhëri nr. 61 datë 28.08.2023, “Rregullore e brendshme e Drejtorisë së Laboratorit”.

6. Urdhëri nr. 123, datë 09.11.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhërin nr. 90, datë 18.11.2014 “Për miratimin e Kodit të Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar.

Procedura e përzgjedhjes do të bëhet në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Genti Gazheli**

